




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 15/04/22

Ref.: 470/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 97-të, të mbajtur më 05.04.2022, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2025:
 1. Farmaci, MPh 300 ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik.
- II. Numri i përcaktuar i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Fakulteti i Mjekësisë i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri më datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

Fakulteti i Mjekësisë i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1	Farmacii, MPh 300 ECTS Ri-akreditim	Kreshnik Hoti Dashnor Nebija Mimoza Basholli-Salihu Rozafa Koliqi - Lila Arlinda Daka Grapci

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC.

AKA ka organizuar vizitën me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Vizita është organizuar më 25.02.2022, me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me këtë përbërje: Kenneth Wann, Joke Denekens dhe Marko Komšo.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportin e vlerësimit, dhe për këtë program, bazuar në fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimin si në vijim:


1. Për programin e studimit Farmacia, MPh 300 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1), substancialisht tri (3), pjesërisht tri (3).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 97-të, të mbajtur më 05.04.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakultetit të Mjekësisë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

